




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
MUNICIPALITY OF SUHAREKA-OPSTINE SUVA REKA



ZYRA E PROKURIMIT

Nr. 020/2020

Nr. Protokoli: 61/2020

Për:	Eko Term Sh.P.K, rruga Brigada 123, Suharekë
Kopje:	z.Bali Muharremaj, Kryetar i Komunës së Suharekës
Nga:	Afrim BYTYQI, u.d. Shef i Prokurimit
Lënda:	VENDIM
Datë:	20/07/2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Suharekës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 7 (paragrafi 7.1 pika a) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 16.07.2020 të parashtruar nga Operatorët Ekonomik: **Eko Term Sh.P.K, rruga Brigada 123, Suharekë** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi I Qerdhes të fëmijeve në Samadraxhë- Faza II, me Nr. të Prok: 624-20-1863-5-2-1 & 624-020-033-521, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa për Ri-shqyrtim e OE Eko Term Sh.P.K, rruga Brigada 123, Suharekë, e datës: 16.07.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Ndërtimi I Qerdhes të fëmijeve në Samadraxhë- Faza II, me Nr. të Prok: 624-20-1863-5-2-1 & 624-020-033-521, kundër Njoftim për Vendimin e AK –së, të datës 08.07.2020 të publikuar në platformen elektronike,
2. **Vërtetohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AK të publikuar me datë: 08.07.2020.**
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues, Komuna Suharekë me datë 16.07.2020, ka pranuar kërkesën për ri-shqyrtim të aktivitetit të prokurimit "Ndërtimi I Qerdhes të fëmijeve në Samadraxhë- Faza II, me Nr. të Prok: 624-20-1863-5-2-1 & 624-020-033-521, kundër Njoftim për Vendimin e AK –së, të datës 08.07.2020 të publikuar në platformen elektronike. Autoriteti Kontraktues pasi shqyrtoi kërkesën tuaj për Ri-shqyrtim, refuzon kërkesën për arsye se e njëjta është parashtruar pas kalimit të afatit të rregullt ligjor të paraparë sipas dispozitave ligjore të LPP-së. Andaj bazuar në të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së.
Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas pranimi të këtij vendimi.

u.d. Shef i Prokurimit
Afrim BYTYQI

